



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 5173/Prot.

Tiranë, më 6/122013

Lënda: ⁴ Rekomandim për "Autoshkolla Laze", Tiranë

REKOMANDIM

Nr. 51, datë 06/12/2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit ,

KONSTATOVA

Nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, "Autoshkolla Laze", Tiranë me objekt:

Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave "klient/studentëve":

- Mënyrat e mbledhjes, regjistrimit, përpunimit, përhapjes së të dhënave të klientëve/studentëve
- Plotësimi i detyrimit për të njoftuar.

Nga kontrolli administrativ u konstatua se:

Kontrolluesi "Autoshkolla Laze" është një shkollë për edukimin rrugor, instruktimin dhe formimin e drejtuesve të mjeteve dhe ushtron aktivitetin e tij të lirë privat.

Gjatë aktivitetit të tij kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale në një regjistër fizik të quajtur "regjistri themeltar i autoshkollës". Në këtë regjistër regjistrohen të dhënat e klientëve/studentëve të cilët janë pajisur me mjetin e qarkullimit rrugor (patentë). Kjo për arsye se në rast shkatërrimi apo humbje të patentës klienti/studenti të ketë mundësinë e nxjerrjes së një kopje të dytë të mjetit të qarkullimit rrugor.

U konstatua se ne regjistrin fizik mblihdeshin, përpunoheshin nga kontrolluesi të dhëna për kategorinë klient/studentë si: emri, mbiemri, foto, raport mjekësor, nr. telefoni, dëshmi e kryqit të kuq.

Këto të dhëna mbaheshin vetëm për ti ardhur në ndihmë klientëve/studentëve të cilëve ju duhet një kopje e dytë e mjetit të qarkullimit rrugor të lëshuar nga kontrolluesi Autoshkolla Laze si dhe për kontrollet e ushtruara nga inspektorët e Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor bazuar në udhëzimin Nr. 994, datë 12.03.2003 "Për organizimin dhe

funkcionimin e autoshkollave”, i ndryshuar. Këto të dhëna nuk përdoren për ndonjë qëllim tjetër.

Tek regjistri fizik i quajtur “regjistri themeltar i autoshkollës” kishte akses vetëm një person, personi përgjegjës. Ky regjistër mbahej në një dollap të veçant dhe dera e zyrës në të cilën ndodhej ky regjistër kyçej po nga personi përgjegjës. Në lidhje me kofidencialitetin këto të dhëna të kandidatëve për leje qarkullimi (patentë) aksesoheshin vetëm nga personi përgjegjës dhe nuk përhapeshin ose përdoren për qëllime të tjera përveç vënies në dispozicion të këtyre të dhënave inspektorëve të DPTRR kur kryenin kontrollin.

Gjithashtu nga kontrolli administrativ që u krye pranë kontrolluesit Autoshkolla Laze u konstatua se **nuk** mbledh apo përpunon të dhëna personale në rrugë elektronike përmes një sistemi të veçantë kompjuterik.

Gjatë kontrollit u konstatua se kontrolluesi “Autoshkolla Laze” nuk dispononte një rregullore të brendshme ku të parashikohej mënyra e mbledhjes, përpunimit, kofidencialitetit dhe ruajtjes së të dhënave personale për kategorinë “klientë” në zbatim të nenit 27 pika 2/1 dhe neni 28 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” ku citohet shprehimisht se: *“Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat teknik-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale , në përputhje me ligjin dhe rregulloren të tjera”*.

“Kontrolluesi, përpunuesi dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë kofidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit.....”.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi pretendimet e kontrolluesit si dhe provat e administruara vëren se:

- Kontrolluesi “Autoshkolla Laze” nuk ka një rregullore të shkruar për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen si dhe kofidencialitetin e të dhënave personale të “nxënësve/studentëve”, në zbatim të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale” .

Konstatimet e sipërme përbëjnë shkelje administrative të:

- **Neni 27 pika 2/1 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

“Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat teknik-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale , në përputhje me ligjin dhe rregulloren të tjera”.

- **Neni 28 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

“Kontrolluesi, përpunuesi dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë kofidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit.....”.

Për sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të neneve 27, 28 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të hartohet një rregullore e brendshme lidhur me sigurinë si dhe konfidencialitetin e të dhënave personale të përpunuara për qëllime të ushtrimit të aktivitetit dhe të dhënat e mbledhura. Në të duhet të parashikohen masa konkrete sigurie, detyrimet e kontrolluesit dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave. (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë);
2. Kryerja e këtij detyrimi të rëndësishëm të kryhet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij rekomandimi.
3. Me plotësimin e këtij detyrimi të njoftohet me shkrim pranë Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
4. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit *“Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”*.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

Flora ÇABEJ (POGAÇE)

